

## ANKIMIMET

Çdo taksapagues ka te drejte te ankohet me shkrim per shumen dhe menyren se si jane vlersuar detyrimet e tij, si dhe te apleoje kunder cdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat e Drejtorive perkatese prane Bashkise Prrrenjas .

- Çdo tatimpagues qe e sheh te padrejte vleresimin e detyrimit tatimor apo gjobat e vendosura nga sektori i tatim-taksave te Bashkise , ka te drejte te ankohet tek komisioni i apelimit tatimore te emruar nga kryetari i bashkise.
- Ankimi paraqitet me shkrim brenda 30 diteve nga marrja dijani per aktin administrativ , dhe permban:
  - a) Emrin, adresen dhe NIPT-in e apeluesit;
  - b) Vitin tatimor ,me te cilin lidhet apelimi;
  - c) Natyren dhe shumen e tatimit ose gjobes qe eshte subjekt apelimi;
  - d) Baza ku mbeshetet apelimi;
- Subjekti duhet te permbushe kerkesat e ligjit per parapagimin e detyrimeve perpara depozitimit te ankimit administrativ.
- Pergjigjja e ankeses do te merret me shkrim nepermjet postes, sipas vendimit te dale nga komisioni i apelimit tatimor , mbeshetet ne rregulloren e apelimit tatimor te miratuar nga Keshilli Bashkiak.
- Nje kopje te vendimit, komisioni i apelimit tatimor e dergon ne Drejtorine e te Ardhurave per ndryshimin ose jo te akt-detyrimit.